

VALA E RE NË ORGANIZIMIN STUDENTOR

Analiza e (ri)formimit studentor në
universitetet shtetërore në Shtip, Manastir dhe Tetovë



Këshilli Rinor Nacional
i Maqedonisë



SFERA
INTERNATIONAL



FORUM 16



Младански
Културен
Центар



ФОНДАЦИЈА
ЗА РАЗВОЈ НА
ЛОКАЛНАТА
ЗАЕДНИЦА

Botuesi

Këshilli nacional rinor i Maqedonisë
rr. "Aminta Treti" nr. 29/1-3, 1000 Shkup
www.nms.org.mk
info@nms.org.mk

Për botuesin

Bojan Petrovski, kryetar

Autorët

Mariana Angelova
Kristijan Panev

Kërkuesit

Zoran Ivanov, Fondacioni për zhvillim të komunitetit lokal – Shtip
Mende Sekulovski, Shoqatë për zhvillim të qëndrueshëm SFERA International – Manastir
Marija Kosvoska, Shoqatë për aktivizëm qytetar/civil FORUM 16 – Manastir
Aleksandar Todorovski, Qendra kulturore rinore – Manastir
Metin Muaremi, Qendra për arsim dhe zhvillim – CED

Përkthuesi

Dalibor Sandev

Dizajn dhe shtyp

Libra TP

Viti i botimit

2020

Tirazhi

300 kopje



Projekti është i financuar nga Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedoni. Përbajtja është përgjegjësia e vetme e autorëve dhe grantistit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se tregon pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e hapur – Maqedoni

Përmbajtje

Për projektin	4
Hyrje	5
Lishta e shkurtesave	6
Metodologjia	7
Korniza ligjore e organizimit studentor	9
Organizimi studentor në Universitetin “Goce Delçev” – Shtip	13
Kuvendet studentore e fakultetit	13
Përfaqësuesit e studentëve në kuvendet studentore e fakultetit	17
Organizimi studentor në Universitetin “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir	23
Kuvendet studentore e fakultetit	23
Përfaqësuesit e studentëve në kuvendet studentore e fakultetit	28
Avokati studentor	33
Universiteti “Goce Delçev” – Shtip	35
Univeristeteti “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir	36
Rekomandime të përgjithshme	42

Për projektin

Analiza e organizimit studentor në universitetet shtetërore në Shtip, Manastir dhe Tetovë është bërë në kuadër të projektit “(Ri)formimi studentor”, i financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

Duke pasur parasysh se ky është viti i parë i vendosjes së një modeli krejtësisht të ri të organizimit studentor, qëllimi kryesor i projektit ishte që të stimulohen organizatat studentore dhe rinore për një monitorim aktiv dhe të angazhohen për zgjedhje transparente studentore. Kjo ka rezultuar për të përfaqësuar një organizim studentor transparent dhe informim të studentëve lidhur me mundësitë dhe mënyrat e pjesëmarrjes në zgjedhjet studentore në universitetet, por edhe me ndjekje të transparencës dhe praktikave nëpër universiteteve gjatë procesit të organizimit studentor dhe formimit të kuvendëve të reja studnetore në bazë të kriterëve të përcaktuara saktësisht për të gjitha fakultete. Si rezultat i këtij monitorimi u krijuan konkluzione dhe rekomandime për universitetet, që do të shfrytëzohen gjatë organizimit dhe zbatimit të zgjedhjeve të ardhshme studentore.

Organizatat që përfshihen në këtë projekt janë: Këshilli rinor kombëtar i Maqedonisë, Fondacioni për zhvillimin e komunitetit lokal - Shtip, Qendra kulturore rinore - Manastir, Shoqata për zhvillim të qëndrueshëm SFERA International - Manastir, Shoqata për aktivizëm qytetar FORUM 16 - Manastir dhe Qendra për arsim dhe zhvillim - CED.

Hyrje

Organizimi studentor paraqet një mënyrë dhe model ku studentët marrin pjesë në menaxhimin dhe vendimmarrjen e universiteteve. Organizimi studentor paraqet një mënyrë dhe model në të cilin studentët marrin pjesë në menaxhimin dhe vendimmarrjen e universiteteve. Kushtet dhe shkalla deri në të cilën një universitet do të lejojë studentëve që të marrin pjesë në menaxhimin dhe vendimmarrjen paraqet një tregues i kapacitetit demokratik të universitetit dhe vlerësimin të zërit të studentëve.

Modeli i organizimit studentor dhe veçanërisht modeli i zgjedhjeve studentore gjithmonë kanë qenë një temë në të cilën ndërllidhen politikat dhe interesat e grupeve të ndryshme të interesit. Kultura nënshtruese dhe puna jo transparente kanë qenë karakteristika me të cilat përshkruhej modeli i mëparshëm i organizimit studentor dhe përfaqësimit.

Me miratimin e Ligjit për arsim të lartë në maj 2018¹, u bë një ndryshim të konsidueshëm të kornizës normative të organizimit studentor dhe mënyrës së përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së studentëve në menaxhimin e universiteteve. Ligji vendosi themelet e një modeli të ri të organizimit studentor, me të cilin garantohen parimet dhe metodat themelore e përzgjidhjes së përfaqësuesve të studentëve. Përkatësisht, parlamentet e mëparshme studentore, të regjistruara si shoqata të studentëve kanë humbur statusin e një organi përfaqësues të studentëve në universitetet, dhe u imponua formimi i kuvendeve të reja studentore, si organe të barabarta të universiteteve, të cilat do të paraqesin dhe përfaqësojnë interesat e studentëve. Për atë qëllim, të gjitha universitete duhej t'i rregullojnë statutet e tyre dhe aktet e brendshme juridike, në përputhje me normat e reja ligjore për organizimin studentor.

Qëllimi i kësaj analize është që të analizohet korniza normative e modelit të ri të organizimit studentor, mënyra e përzgjidhjes, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e përfaqësuesve të studentëve dhe ta shqyrtojë transparencën dhe praktikën fillestare, të cilat do të implementohen nga ana e universiteteve, duke formuar kuvende të reja studentore në tre universitetet shtetërore në Shtip, Manastir dhe Tetovë. Si rezultat i kësaj, analiza do të ofrojë konkluzione dhe rekomandime për universitetet dhe studentët.

¹ Ligji për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 81, 8 maj 2018), në tekstin në vijim: LAL

Lishta e shkurtesave

UGD – Universiteti “Goce Delçev” – Shtip

UKLO – Universiteti “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir

UShT – Universiteti shtetëror i Tetovës

KSUUGD – Kuvendi studentor universitar i Universitetit “Goce Delçev” – Shtip

KSUUKLO - Kuvendi studentor unviersitar i Universitetit “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir

LAL – Ligji për arsim të lartë

KSF – Kuvendi studentor i fakultetit

KSU – Kuvendi studentor i Universitetit

OS – Ombudsmani i studentëve

Metodologjia

Qëllimi i kësaj analize është për të shkuar një hap më tej dhe më thellë nga vetëm një analize e kornizës ligjore dhe nënligjore të rregullimit të organizimit studentor. Qëllimi i vetë është i përcaktuar nga dy dimensione kërkimore të problematikës dhe ajo: teoretik dhe aplikativ. I pari është në interes të të dytit dhe duhet të arrijë qëllimin kryesor e kësaj analize.

Analiza bën një sublimat të disa aspekteve kryesore, që janë të rëndësishme për organizimin studentor dhe ajo: korniza ligjore dhe aktet nënligjore, që rregullojnë organizimin studentor dhe zbatimin praktik, duke krijuar organet e reja përfaqësuese të studentëve.

Objekt i monitorimit kanë qenë tre universitetet shtetërore:

- Universiteti “Goce Delçev” – Shtip
- Universiteti “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir
- Universiteti shtetëror i Tetovës.

Në bazë të qëllimeve të përcaktuara, në këtë analizë janë përdorur disa metoda dhe teknika të kërkimit. Janë përdorur metoda cilësore dhe sasiore. Në lidhje me të dhënat, janë përdorur të dhëna primare dhe sekondare.

Të dhënat sekondare janë mbledhur përmes një analize të akteve ligjore dhe nënligjore, monitorimit të të gjitha mediave të universiteteve, duke përfshirë edhe mediat elektronike dhe profilet e tyre në rrjetet sociale, si edhe mjetit për qasje të lirë për informacionet nga karakteri publik për të mbledhur të dhëna relevante, procesverbale dhe kontroll në dokumentacionin

Të dhënat primare janë mbledhur përmes bisedave të drejtpërdrejta me studentët dhe stafin e universiteteve. Të dhënat e mbledhura ishin strukturuar dhe analizuar në bazë të një matrice të përcaktuar më parë, e përbashkët për

të gjitha universitete. Matrica përfshin disa tregues kryesor dhe ajo:

- Koha dhe mënyra e shpalljes së zgjedhjeve studentore,
- Afati për aplikim të kandidatëve,
- Komisioni zgjedhor, dukshmëria dhe transparenca e thirrjes për përzgjidhjen e anëtarëve të kuvendeve studentore,
- Dukshmëria dhe transparenca e zgjedhjeve studentore,
- Data dhe koha e zgjedhjeve, dhe
- Procesi i votimit.

Për më tepër, analiza përfshin edhe të dhënat në lidhje me daljen në votim të studentëve dhe votimin në zgjedhjet studentore.

Në bazë të numrit më të madh të të dhënave dhe informacioneve nga burime të ndryshme, dhe me qëllim miratimi i konkluzioneve të veta relevante, është përdorur metoda e analizës dhe sintezës. Metoda e analizës krahasuese, gjithashtu, ishte e përdorur për krahasimin e të dhënave dhe praktikave midis universiteteve që ishin objekt i monitorimit. Nga metodat sasiore, është përdorur metoda e analizës statistikore dhe vlerësimit statistikor në pjesën e grumbullimit dhe interpretimit të të dhënave nga zgjedhjet studentore.

Kjo analizë ka dy kufizime kryesore. Së pari, gjatë periudhës së monitorimit dhe analizës, një pjesë të fakulteteve në Universitetin “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir tashmë kishin formuar kuvende studentore dhe kishin zgjidhur përfaqësuesit e studentëve, dhe për shkak të kësaj analiza e këtyre fakulteteve bazohet mbi të dhënat sekondare dhe kontrollin në dokumentacion. Së dyti, analiza nuk përmban të dhëna për Universitetin shtetëror të Tetovës, për shkak se universiteti nuk ka informacione në dispozicion publik në faqen e tij të internetit dhe nuk ka përgjigjur kërkesave për qasje të lirë për informacione nga karakteri publik. Zyrat e studentëve, nga ana tjetër në disa raste ishin mbyllur dhe të paarritshme për kërkuesit.

Përmbajtja, gjetjet dhe rekomandimet e kësaj analize janë në drejtim për të rritur diskutimi në lidhje me organizimin studentor, por edhe për të përmirësuar praktikën dhe transparenca e procesit të përgjithshëm të zgjedhjeve studentore dhe pjesëmarrja e studentëve në menaxhimin e universiteteve.

Korniza ligjore e organizimit studentor

Organizimi studentor është i rregulluar me Ligjin për arsim të lartë (*në tekstin në vijim: LAL*), statutet dhe aktet e tjera nënligjore të universiteteve. Në Ligjin për arsim të lartë është paraqitur korniza e përgjithshme të modelit të organizimit studentor dhe mënyra e pjesëmarrjes së studentëve në menaxhimin e universiteteve.

Në vazhdim, disa gjëra kryesore që rregullohen me LAL-in në lidhje me vendosjen dhe funksionimin e modelit të organizimit studentor:

1) Kushtet e punës

Çdo institucion të arsimit të lartë duhet të sigurojë një hapësirë për punë dhe të ofrojë asistencë administrativo-teknike kuvendeve të studentëve, që veprojnë në kornizat e tij.

2) Financimi

Kuvendet studentore financohen nga fondet e institucioneve të arsimit të lartë, d.m.th., nga buxheti vjetor i vetë institucionit të arsimit të lartë, dhe mund të financohen edhe nga: trashëgimi, dhurata, donacione, kontribute dhe burime të tjera.

Kuvendet studentore menaxhojnë fondet në mënyrë të pavarur, në mënyrën që do ta përcaktojnë në mënyrë të pavarur në Statutin e tyre, dhe institucionet e arsimit të lartë kryejnë vetëm mbikëqyrjen e shpenzimit të qëllimshëm të fondeve, që ato i japin kuvendeve studentore.

3) Struktura e organizimit

Kuvendi studentor i universitetit

Kuvendi studentor i universitetit është një organ universitar i përbërë nga studentë, që përfaqësojnë studentët në vetë universitetin dhe në komunitetin akademik. Kuvendi studentor i universitetit përfaqëson dhe mbron interesat e studentëve, merr pjesë me përfaqësues të tij në vendimmarrjen në organet dhe trupat e universitetit.

Kompetencat: Kuvendi studentor i universitetit në korniza të kompetencave të tij mund

- Të zgjidhë përfaqësuesit e studentëve në Senatin dhe organet dhe trupat e tjera të universitetit,
- Të miratojë një plan dhe program për punën e tij,
- Të propozojë ombudsmenin studentor ,
- Të kujdeset për jetën e studentit dhe cilësinë e procesit të studimit, standardin studentor, realizimin e të drejtave dhe interesave të studentëve dhe për përmirësimin kulturor, shoqëror dhe intelektual të studentëve,
- Të propozojë organeve drejtuese një plan për financimin e aktiviteteve të studentëve,
- Të stimulojë aktivitetet e studentëve jashtë procesit mësimor,
- Të miratojë akte të përgjithshme në kuvendin e studentëve në përputhje me Ligjin dhe Statutin e Universitetit,
- Të kryejë aktivitete të tjera me interes për studentët.

Përbërja: Kuvendi studentor i universitetit është i përbërë nga dy studentë – përfaqësues nga secili fakultet dhe/ose shkolla e lartë profesionale, që zgjidhen nga radhët e përfaqësuesve në kuvendet studentore të fakultetit. Kuvendi studentor i universitetit ka kryetar, që zgjidhet nga radha e anëtarëve të vetë kuvendit. Mandati i të gjithë anëtarëve, duke përfshirë edhe mandatin e kryetarit, zgjat një (1) vit, me të drejtën për rizgjidhje.

Financimi: Financohet me fondet e Universitetit, në kornizat e të cilit vepron kuvendi studentor i Universitetit.

Organizimi i punës: Organizimi më i detajuar i punës dhe mënyra e zgjidhjes së organeve të brendshme dhe përfaqësuesve në organet dhe trupat e Universitetit rregullohen nga vetë kuvendi studentor i Universitetit në Statutin e tij. Statuti miratohet nga vetë kuvendi, me pëlqim paraprak të Senatit të Universitetit.

Kuvendi studentor i fakultetit

Kuvendi studentor i fakultetit është një organ i fakultetit i përbër nga studentë të regjistruar në fakultetin specifik.

Përbërja dhe kompetencat: Kuvendi studentor i fakultetit është i përbërë nga studentë, që janë regjistruar në studime në një fakultet specifik në vitin akademik në të cilin zgjidhen përfaqësuesit e studentëve. Numri i anëtarëve në kuvendin studentor të fakultetit nuk është i përcaktuar me ligj.

Kuvendi studentor i fakultetit përfaqëson dhe mbron të drejtat dhe interesat e studentëve. Emëron dhe shkarkon përfaqësuesit e studentëve në organet e fakultetit në përputhje me ligjin dhe statutet e Universitetit dhe fakultetit.

Çdo kuvend studentor i fakultetit ka kryetarin e tij. Kryetari përfaqëson studentët dhe kuvendin studentor të fakultetit, është përgjegjës për punën e kuvendit dhe është i detyruar për të zbatuar vendimet e marra nga kuvendi studentor i fakultetit.

Zgjedhjet studentore: Përfaqësuesit e kuvendit studentor të fakultetit zgjidhen në **zgjedhje të drejtpërdrejta, fer dhe demokratike me votim të fshehtë**, për dallim nga përfaqësuesit e kuvendit studentor të Universitetit, që zgjidhen drejtpërdrejtë nga kuvendet studentore të fakultetit.

Kryetari i kuvendit studentor të fakultetit, gjithashtu, zgjidhet në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe të fshehta.

E drejta për të zgjidhur dhe që të zgjidhen kanë të gjithë studentët, që janë regjistruar në atë fakultet në vitin akademik në të cilin zgjidhet kuvendi studentor i fakultetit

Mandati i anëtarëve të kuvendit është **një vit me të drejtën për vetëm një rizgjidhje.**

Zgjedhjet studentore mbahen çdo vit në kohë të përcaktuar në statutin e kuvendit studentor të Universitetit. Zgjedhjet studentore shpallen nga dekani i secilit fakultet **brenda 30 ditëve para mbajtjes së tyre**, dhe nëse dekani i fakultetit nuk shpall zgjedhjet brenda afatit të caktuar, kjo e bën rektorin e Universitetit brenda tre (3) ditëve pas skadimit të afatit të caktuar me ligj prej 30 ditëve.

Në vetë vendimin për shpallje të zgjedhjeve në mënyrë të detyrueshme duhet të përcaktohet edhe komisioni zgjedhor, që është përgjegjës për realizimin e zgjedhjeve studentore në atë fakultet. Komisioni duhet të përbëhet nga studentë dhe profesorë ose bashkëpunëtorë, **ku shumica në komision duhet ta kenë studentët.**

Ligji për arsim të lartë lë hapësirë zgjedhjet studentore, procedura e përgjithshme, numri i anëtarëve të kuvendit studentor të fakultetit dhe mënyra e zgjidhjes të rregullohen me statutet e secilit fakultet, që duhet të jenë në përputhje me statutet e Universitetit.

Financimi: Kuvendi studentor i fakultetit financohet nga fondet e fakultetit në të cilin operon.

Organizimi i punës: Si kuvendi i Universitetit, ashtu edhe kuvendi studentor i fakultetit e rregullon punën e vetë me statutin e tij të vetë, për të cilin duhet të merrë pëlqim nga këshilli mësimdhënës-shkencor.

Konkluzionet:

- Korniza ligjore garanton një model sistematik i organizimit studentor, në të cilin kuvendet studentore janë organe të universiteteve dhe fakulteteve, që mbrojnë dhe përfaqësojnë studentët dhe interesat e tyre dhe janë përbërë nga vetë studentët.
- Kuvendet studentore financohen nga fondet e fakultetit, d.m.th., Universitetit, dhe ekziston një mundësi edhe për financim me dhurata, donacione, kontribute dhe burime të tjera.
- Çdo kuvend studentor ka kryetar, si i pari ndër të barabartëve në kuvendin.
- Korniza ligjore garanton zgjedhje të rregullta për kuvendet studentore çdo vit. Mandati i të gjithë anëtarëve është vetëm një (1) vit, me të drejtën për një (1) rizgjidhje. Me këtë garantohet se një student nuk mund të jetë anëtar i kuvendit studentor më shumë se dy (2) vite.
- Është pasigurt në të cilën periudhë të vitit akademik shpallen zgjedhjet studentore. Korniza ligjore garanton vetëm shpalljen e zgjedhjeve 30 ditë para mbajtjes së tyre dhe mekanizmin e kufizimit të së drejtës diskrecionale të dekanëve të fakulteteve, nëse nuk mbahen zgjedhjet brenda këtij afati.
- Procesi zgjedhor i zgjedhjeve studentore udhëhiqet nga komisioni zgjedhor, që është i përbërë edhe nga studentë edhe nga profesorë, d.m.th., bashkëpunëtorë të fakulteteve.
- Korniza ligjore garanton një fleksibilitet të caktuar dhe mundësi për të përshtatur ndaj specifikave lokale të secilit fakultet në lidhje me madhësinë dhe numrin e anëtarëve në kuvendet studentore të fakultetit.

Organizimi studentor në Universitetin “Goce Delçev” - Shtip

Në Universitetin “Goce Delçev” – Shtip (në tekstin në vijim: UGD) veprojnë gjithsej 15 njësi, nga të cilat 3 akademi dhe 12 fakultete.

Organizimi studentor në UGD është i rregulluar më saktësisht me Statutin e Universitetit në pjesën e pjesëmarrjes së studentëve në menaxhimin.

Korniza statutare:

1) Kuvendet studentore e fakultetit

Përbërja e KSF: UGD merr një qasje të unifikuar në lidhje me numrin e përfaqësuesve të studentëve në kuvendet studentore të fakultetit. Duka pasur parasysh kornizën ligjore, me statutin e UGD-së rregullohet se çdo kuvendi studentor i fakultetit të secilës njësie të Universitetit përbëhet nga dhjetë (10) anëtarë, që zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, fer dhe demokratike me votim të fshehtë.

Zgjedhjet studentore:

Shpallje: Zgjedhjet në secilen njësi të UGD-së shpallen nga dekani i asaj njësie, me një vendim brenda 30 ditëve para mbajtjes së tyre.

Komisioni zgjedhor: Me vendim për shpalljen e zgjedhjeve, dekani i njësisë emëron edhe komisionin zgjedhor, që përbëhet nga pesë (5) anëtarë, nga të cilët tre studentë dhe dy profesorë, d.m.th., bashkëpunëtorë të asaj njësie.

Dita e zgjedhjeve: Është i fshehtë votimi për zgjidhjen e anëtarëve dhe kryetarit të kuvendeve studentore të fakultetit. Procesi zgjedhor udhëhiqet nga komisioni

Kuvendet studentore e fakultetit

Numri i anëtarëve: 10

Mandati: një (1) vit me të drejtën për rizgjidhje

Zgjedhjet: të fshehta dhe të drejtpërdrejta

Kryetari: zgjidhet nga radha e anëtarëve të KSF

Mënyra e shpalljes së zgjedhjeve: Vendimi i dekanit

Afati i shpalljes: më së voni 30 ditë para mbajtjes

Komisioni zgjedhor: 5 anëtarë (3 studentë dhe 2 profesorë/bashkëpunëtorë)

Financimi: nga fondet e

zgjedhor, që konfirmon edhe rezultatet. Komisioni zgjedhor ka për detyrë për të hartuar fletëvotime të veçanta, që duhet të jenë me të njëjtën madhësi dhe me të njëjtën ngjyrë. Kandidatët për zgjidhje të anëtarëve të kuvendeve studentore të fakultetit regjistrohen në rend alfabetik sipas mbiemrit të tyre, dhe para mbiemrit futet numri rendor.

Procedura e numërimit dhe rezultatet: Komisioni zgjedhor së pari përcakton numrin e studentëve, që kanë votuar në zgjedhjet studentore, kështu që së pari numërohen fletëvotimet e papërdorura dhe vulosen në një zarf të veçantë. Pastaj, komisioni konstaton sa studentë kanë votuar sipas listës, e hap kutinë e votimit dhe i numëron votat. Nëse numrat nuk përshtaten, rezultatet nga votimi konstatohen sipas numrit të fletvotimeve në kutinë e votimit, dhe jo sipas numrit të studentëve të shënuar në listën e votimit se kanë votuar.

Pas numërimit të votave, komisioni zgjedhor në një procesverbal i përcakton rezultatet. Procesverbali, së bashku me listën e votimit dhe fletëvotimet e papërdorura futen në një zarf që vulloset. Në këtë zarf vendosen edhe fletvotimet e papërdorura veç e veç.

2) Kuvendi studentor i Universitetit

Çdo kuvend studentor i fakultetit emëron nga dy përfaqësues në kuvendin studentor të Universitetit.

Kryetari i kuvendit studentor të Universitetit zgjidhet me votim të fshehtë nga radha e përfaqësuesve të emëruar në kuvendin studentor të Universitetit, në një seancë konstituive në të cilën marrin pjesë më së paku 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.

Mandati i anëtarëve dhe mandati i kryetarit është një (1) vit, me të drejtën për një rizgjidhje.

3) Organizimi studentor në praktikë

Universiteti “Goce Delçev” – Shtip ka marrë një qasje të koordinuar uniforme në implementimin e modelit të organizimit studentor në të gjithë fakultete dhe në të gjitha akademi, që operojnë në kornizat e tij.

Koha dhe mënyra e shpalljes së zgjedhjeve: Zgjedhjet për përfaqësues të studentëve në kuvendet studentore të fakultetit, në çdo fakultet ishin shpallu me vendime të koordinuara të veçanta të dekanëve në të njëjtën ditë – 04.11.2019.

Afati për aplikim: Afati për aplikim të kandidatëve për përfaqësues të studentëve në kuvendet studentore të fakultetit

në të gjitha fakultete ishte tetë (8) ditë, d.m.th., deri më 12.11.2019.

Komisioni zgjedhor: Në përputhje me Statutin e Universitetit “Goce Delçev” – Shtip, çdo dekan në vendimin për shpallje të zgjedhjeve studentore kishte emëruar nga një komision zgjedhor, i përbërë nga pesë (5) anëtarë, nga të cilët tre (3) studentë dhe dy (2) profesorë, d.m.th., bashkëpunëtorë.

Dukshmëria dhe transparenca e thirrjes për zgjidhjen e anëtarëve në KSF: Universiteti “Goce Delçev” – Shtip ka përdorur katër (4) lloje të mediave për të informuar studentët lidhur me mundësinë e kandidimit për përfaqësues të studentëve, si vijon:

- dy faqe të internetit të UGD-së (www.ugd.edu.mk dhe www.life.ugd.edu.mk)
- dërrasat e shpalljeve në selinën dhe kampuset në të gjitha fakultete
- radio e Unviersitetit – UGD FM, dhe
- faqet zyrtare e fansave të Universitetit “Goce Delçev” – Shtip në rrjetën sociale *Facebook*

<https://www.facebook.com/ugdlife/>

<https://www.facebook.com/ugdstop/>

<https://www.facebook.com/UGDFM>

Për më tepër, tetë (8) fakultete kanë shpallur thirrjen publike edhe në faqet zyrtare e fakultetit të vetë për zgjidhjen e kandidatëve për kuvendet studentore.²

Dukshmëria dhe transparenca e zgjedhjeve studentore: Universiteti “Goce Delçev” – Shtip ka përdorur të njëjtat katër (4) lloje të mediave për të informuar studentët lidhur me të drejtën e tyre të votimit, ditën dhe kohën e mbajtjes së zgjedhjeve studentore, si vijon:

- dy faqe të internetit të UGD-së (www.ugd.edu.mk dhe www.life.ugd.edu.mk)
- dërrasat e shpalljeve në selinë dhe kampuset në të gjitha fakultete
- radio e Universitetit – UGF FM, dhe
- faqet zyrtare e fansave tl Universtetit “Goce Delçev” – Shtip në rrjetën sociale *Facebook*

² Akademia muzikore, Fakulteti i shkencave natyrore dhe teknike, Fakulteti i bujqësisë, Fakulteti ekonomik, Fakulteti juridik, Fakulteti i turizmit dhe biznes logjistikës, Fakulteti i shkencave arsimore dhe Fakulteti i filologjisë

<https://www.facebook.com/ugdlife/>
<https://www.facebook.com/ugdstip/>
<https://www.facebook.com/UGDFM>

Për më tepër, tetë (8) fakultete kanë shpallur thirrjen publike edhe në faqet zyrtare e fakultetit të vetë për zgjidhjen e kandidatëve për kuvendet studentore.³


Data dhe koha e zgjedhjeve: Zgjedhjet studentore në të gjitha fakultet u mbajtën në të njëjtën ditë, në të njëjtën kohë nga ora 10 deri në orën 15, në ditën e 30-të pas shpalljes së zgjedhjeve, d.m.th., më 04.12.2019.

Procesi i votimit: Komisioni zgjedhor në çdo fakultet ka pasur listën e zgjedhësve. Në çdo lokacion ku ishte organizuar votimi kishte siguruar një kuti votimi dhe paravanë për të siguruar fshehtësia e votimit. Megjithatë, një pjesë të paravanëve ishin të improvizuar, nuk ishin të unifikuar dhe ekzistonte mundësi për të shkelur fshehtësia e votimit. E drejta e votimit realizohet me indeks të studentit. Pas përfundimit të zgjedhjeve dhe numërimit të votimeve, çdo komision zgjedhor kishte hartuar një procesverbal për të konstatuar rezultatet nga votimi për zgjidhjen e anëtarëve në kuvendet studentore e fakultetit.

³ Akademia muzikore, Fakulteti i shkencave natyrore dhe teknike, Fakulteti i bujqësisë, Fakulteti ekonomik, Fakulteti juridik, Fakulteti i shkencave elektroteknike, Fakulteti i shkencave arsimore dhe Fakulteti i filologjisë

Përfaqësuesit e studentëve në kuvendet studentore e fakultetit

Proporcioni i kandidatëve të paraqitur dhe të zgjidhur për anëtarë të kuvendeve studentore të fakultetit




Zgjedhjet studentore në Universitetin “Goce Delçev” Shtip

■ Gjithsej votat


■ Të vlefshme

■ Të pavlefshme


■ Të papërdorura




Akademia e filmit




Akademia e artit




Akademia muzikore




Fakulteti juridik




Fakulteti ekonomik




Fakulteti i filologjisë




Fakulteti i shkencave arsimore




Fakulteti i bujqësisë




Fakulteti i shkencave mjekësore




Fakulteti i turizmit dhe logjistikës së biznesit




Fakulteti i shkencave teknologjike dhe teknike




Fakulteti i shkencave natyrore dhe teknike



Fakulteti i inxhinierisë mekanike



Fakulteti i inxhinierisë elektrike



Fakulteti i shkencave të informatikës

Gjetjet kryesore:

- Universiteti “Goce Delçev” – Shtip krijon një organizim uniform dhe të koordinuar studentor në të gjitha fakultete dhe në të gjitha akademi, që funksionojnë në kornizat e tij.

- Çdo kuvendi studentor i fakultetit (duhet të përbëhet) është i përbërë nga 10 anëtarë, pavarësisht numrit të studentëve, që janë të regjistruar në fakultetin. Për dy kuvende studentore të fakultetit (të akademisë së filmit dhe fakultetit të shkencave arsimore) fillimisht kanë aplikuar një numër më të vogël të kandidatëve për përfaqësues të studentëve. Në akademinë e filmit janë regjistruar gjithsej shtatë (7) studentë në vitin akademik në të cilin u mbajtën zgjedhjet studentore, që tregon një mungese initiale të qasjes së barabartë për të njëjtin numër të anëtarëve të secilit kuvend studentor të fakultetit.

- Përfaqësuesit e kuvendeve studentore të fakultetit zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, fer dhe demokratike me votim të fshehtë.

- Kryetarët e kuvendeve studentore të fakultetit zgjidhen nga radha e anëtarëve të kuvendit studentor të fakultetit.

- Zgjedhjet studentore shpallen në të njëjtën kohë, me vendime të koordinuara të dekanëve të të gjitha fakulteteve brenda UGD-së.

- Në vendimet për shpalljen e zgjedhjeve studentore emërohen komisionet zgjedhore. Të gjitha komisione zgjedhore janë përbërë nga pesë (5) anëtarë, nga të cilët tre (3) studentë dhe dy (2) profesorë ose bashkëpunëtorë.

- Afati për aplikim të kandidatëve për përfaqësues të studentëve në kuvendet studentore të fakultetit në të gjitha fakultete të UGD-së është i njëjtë dhe zgjat tetë (8) ditë.

- UGD kryesisht përdor mediat elektronike dhe kanalet e informimit të studentëve për procesin zgjedhor, si vijon: faqet e internetit, rrjetet sociale dhe radioja e universitetit. Përveç kësaj, për informimin e studentëve përdoren edhe dërrasat e shpalljeve në fakultetet.

- Zgjedhjet studentore në të gjitha fakultete të UGD-së mbahen në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë.

- Të gjitha komisionet zgjedhore kanë listat zgjedhore. Votimi bëhet me indeks. Për rezultatet nga zgjedhjet studentore, të gjitha komisione hartojnë nga një procesverbal.

- Në situatën kur kuvendi studentor i fakultetit numëron 10 anëtarë, UGD nuk ka krijuar një model zgjedhor në rast kur më shumë kandidatë do të marrin numrin e njëjtë të votave. Në tre (3) fakultete, më shumë kandidatë kanë marrë numrin e njëjtë të votave.

- Dalja e përgjithshme në votim në zgjedhjet studentore në nivel të Universitetit është 14.2%. Në përgjithësi, dalje më e madhe ka në fakultetet ku janë regjistruar më pak studentë. Në përqindje, dalja më e madhe është në Akadaminë e filmit dhe në Fakultetin e shkencave arsimore, dhe dalja më e ulët është në Fakultetin e shkencave natyrore dhe teknike dhe në Fakultetin e filologjisë. Kuvendi studentor i Universitetit të UGD-së është i përbërë nga gjithsej 30 anëtarë – nga dy (2) delegatë nga secili kuvend studentor i fakultetit.

- Kryetari i kuvendit studentor të Universitetit zgjidhet nga radha e anëtarëve të vetë kuvendi me votim të delegatëve.

Rekomandimet:

- Të vazhdohet me praktikën e përdorimit të të gjitha mediave universitare në dispozicion për të informuar në mënyrë transparente studentët lidhur me procesin e zgjedhjeve studentore.

- Të rregullohet qasja për numrin e anëtarëve të kuvendeve studentore të fakultetit në varësi të specifikave dhe numrit të studentëve në fakultetet. Qasja e unifikuar nga saktë 10 studentë në çdo kuvend studentor të fakultetit është e paqëndrueshme për fakultetet dhe/ose akademitë më të vogla. Një qasje më e përshtatshme do të jetë që të garantohet një kornizë me një numër minimal dhe maksimal të anëtarëve në kuvendet studentore të fakultetit, dhe vetë fakultetet

ta rregullojnë numrin e saktë të anëtarëve në KSF përkatës.

- Të vazhdohet praktika e shpalljes dhe mbajtjes së zgjedhjeve studentore në të gjitha njësitë e Universitetit në të njëjtën ditë. Kjo rrit dukshmërinë dhe informimin e studentëve për zgjedhjet studentore.

- Të praktikohet një afat më të madh kohor për informimin dhe regjistrimin e studentëve për anëtarë të kuvendeve studentore të fakultetit. Afati prej tetë (8) ditëve duket se është i pamjaftueshëm për të informuar plotësisht studentët dhe që të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm.

- Procesi i vendosur i votimit në Statusin e UGD-së, duke thirur studentët gjatë votimit nga ana e komisionit zgjedhor, lë hapësirë për shkeljen e fshehtësisë së votimit.

- Të përcaktohet një model dhe një zgjidhje zgjedhore si do të vendoset në rast kur më shumë kandidatë kanë marrë numrim e njëjtë të votave, dhe në atë rast të gjithë ata nuk mund të bëhen anëtarë të kuvendeve studentore të fakultetit. Tashmë në zgjedhjet e para studentore u shfaqën situata të këtilla në tre (3) fakultete.

- Të përcaktohet një mënyrë dhe një procedurë për zgjidhjen e kryetarëve të kuvendeve studentore të fakultetit. Është e pasigurtë a mënyra aktuale e pëzgjdhjes së kryetarit nga radha e anëtarëve të zgjidhur të kuvendeve studentore të fakulteteve paraqesin zgjedhje të drejtëpërdrejta dhe të fshehta, të parapara me ligjin.

Organizimi studentor në Universitetin “Sh. Kliment i Ohrit” - Manastir

Në Universitetin “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir (në tekstin në vijim: UShKO) funksionojnë gjithsej 11 njësi, nga të cilat 10 fakultete dhe 1 shkollë e lartë profesionale.

Organizimi studentor në UshKO më saktësisht është i rregulluar me Statutin e Universitetit në pjesën e pjesëmarrjes së studentëve në menaxhimin.

Korniza statutare:

1) Kuvendi studentor i fakultetit

Përbërja e KSF: UShKO në Statutin e tij nuk rregullon në mënyrë të detajuar numrin e anëtarëve të kuvendeve studentore të fakultetit. Në Statutin parashikohet se organet, procedura e përzgjidhjes dhe shkarkimit dhe numri i anëtarëve, kuvendet studentore e fakultetit do t'i rregullojnë të vetët në statutet e tyre.

Zgjedhjet studentore:

Shpallje: Zgjedhjet në secilën njësi të UshKO shpallen nga ana e dakanit të asaj njësie, me një vendim brenda 30 ditëve para mbajtjes së tyre.

Komisioni zgjedhor: Me vendimin për shpalljen e zgjedhjeve, dekani i njësisë emëron edhe komisionin zgjedhor, që është i përbërë nga pesë (5) anëtarë, prej të cilëve tre studentë dhe dy profesorë, d.m.th., bashkëpunëtorë të asaj njësie. Komisionet zgjedhore për zbatim të zgjedhjeve janë të autorizuara për të përzgjidhur këshillat zgjedhore ose nënkomisionet, që janë të përbëra nga dy (2) studentë dhe një (1) profesor ose bashkëpunëtor.

Kuvendet studentore e fakultetit

Numri i anëtarëve: Çdo KSF rregullon në mënyrë të pavarur

Mandat: një (1) vit me të drejtën për rizgjidhje
Zgjedhjet: të fshehta dhe të drejtëpërdrejta

Kryetar: zgjidhet në zgjedhje të fshehta dhe të drejtëpërdrejta

Mënyra e shpalljes së zgjedhjeve: vendimi i dekanit

Afati i shpalljes: më së voni 30 ditë para mbajtjes

Komisioni zgjedhor: 5 anëtarë (3 studentë dhe 2 profesorë/bashkëpunëtorë)

Financimi: nga fondet e fakultetit

Procesi dhe procedura e votimit: Në mënyrë identike me normat juridike, Statuti i UshKO parashikon vetëm se zgjedhjet për përzgjidhjen e anëtarëve dhe kryetarit të kuvendeve studentore të fakultetit zhvillohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, demokratike dhe fer me votim të fshehtë. UshKO me Statutin e tij nuk rregullon në detaje procedurën e zgjedhjeve, rrjedhjen e votimit dhe numërimin e rezultateve. Mundësia për një rregullim të detajuar të procesit dhe procedurës së votimit parashihet që të rregullohet me statutet e vetë kuvendeve studentore të fakultetit.

2) Kuvendi studentor i Universitetit

Kuvendi studentor i Universitetit të UshKO është i përbërë nga dy përfaqësues të emëruar nga çdo kuvend studentor i fakultetit dhe nga kuvendi studentor i shkollës së lartë profesionale.

UshKO me **Statutin e Universitetit** ka rregulluar strukturën e brendshme dhe mënyrën e zgjidhjes së organeve të kuvendit studentor të Universitetit. Në përputhje me dispozitat e Statutit, KSU i UshKO ka kryetarin, organin ekzekutiv dhe organin mbikëqyrës, dhe nëse ka nevojë edhe organet e tjera ndihmëse.

Kryetari i kuvendit studentor të Universitetit zgjidhet nga radha e përfaqësuesve të emëruar në kuvendin studentor të Universitetit dhe i njëjti duhet të ketë statusin e studentit të rregullt.

Organi ekzekutiv është i përbërë nga pesë (5) anëtarë, që zgjidhen nga kuvendi studentor i Universitetit dhe të gjithë ata duhet të kenë statusin e studentëve të rregullt.

Organi mbikëqyrës është i përbërë nga tre (3) anëtarë, që zgjidhen nga kuvendi studentor i Universitetit dhe të gjithë ata duhet të kenë statusin e studentëve të rregullt.

Mandati i të gjithë anëtarëve të kuvendit studentor të Universitetit, si edhe i kryetarit dhe anëtarëve të organit ekzekutiv dhe mbikëqyrës është një (1) vit, me të drejtën për rizgjidhje.

Anëtarët e organit ekzekutiv dhe mbikëqyrës duhet të jenë nga njësi të ndryshme, d.m.th., fakultete. Për zgjidhjen e anëtarëve të këtyre organeve vendoset në një mbledhje, në të cilën duhet të marrin pjesë shumica e anëtarëve të kuvendit studentor të Universitetit, dhe vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

3) Organizimi studentor në praktikë

Universiteti “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir nuk praktikon një qasje të koordinuar në vendosjen e modelit të organizimit studentor në të gjitha fakultete dhe shkollën e lartë profesionale, që funksionojnë në kornizat e tij.

Koha dhe mënyra e shpalljes së zgjedhjeve: Zgjedhjet për përfaqësuesit e studentëve në kuvendet studentore të fakultetit në çdo fakultet shpallen me vendim të dekanit të fakultetit, d.m.th., drejtorit të shkollës së lartë profesionale. Shpallja e zgjedhjeve nuk koordinohet midis fakulteteve.

Afati për aplikim: Afati për aplikim të kandidatëve për përfaqësues të studentëve në kuvendet studentore e fakultetit në të gjitha fakultete ka qenë shtatë (7) ditë.

Komisioni zgjedhor: Në përputhje me Statutin e Universitetit “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir, çdo dekan në vendimin për shpallje të zgjedhjeve studentore ka emëruar nga një komision zgjedhor, i përbër nga pesë (5) anëtarë, nga të cilët tre (3) studentë dhe dy (2) profesorë, d.m.th., bashkëpunëtorë. Komisionet zgjedhore kanë qenë të autorizuara për të formuar këshillat zgjedhore, d.m.th., nënkomisione të përbëra nga tre (3) anëtarë dhe ajo dy (2) studentë dhe një (1) profesor, d.m.th., bashkëpunëtor i fakultetit.

Dukshmëria dhe transparenca e thirrjes për zgjidhjen e anëtarëve të KSF: Universiteti “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir ka përdorur tre (3) lloje të mediave për të informuar studentët lidhur me mundësinë e kandidimit për përfaqësues të studentëve, si vijon

- Faqet e internetit të secilit fakultetit të UshKO
- Dërrasat e shpalljes në selinë dhe kampuset e të gjitha fakulteteve
- Faqet zyrtare e fansave të fakulteteve dhe shkollës së lartë profesionale në korniza të UshKO në rrjetën sociale

Facebook

Në disa prej fakulteteve të UshKO, faqet e internetit kanë vonuar me përditësimin e informacioneve lidhur me thirrjen për zgjidhje të përfaqësuesve të studentëve dhe me mbajtjen e zgjedhjeve studentore.

Data dhe koha e zgjedhjeve: Zgjedhjet studentore në fakultetet dhe shkollën e lartë profesionale u mbajtën në ditë të ndryshme, në varësi të vendimeve për shpalljen e zgjedhjeve studentore. Në dy (2) fakultete (Fakulteti i pedagogjisë dhe Fakulteti i shkencave të teknologjisë informative dhe komunikimit), zgjedhjet studentore u mbajtën brenda një periudhe më të gjatë sesa ai i parashikuar me ligj prej 30 ditëve nga shpallja e zgjedhjeve.

Në disa prej fakulteteve ekziston një diferencë kohore midis vendimit të miratuar të dekanit për shpalljen e zgjedhjeve dhe publikimit faktik të shpalljes për kandidatë për anëtarë dhe kryetar të kuvendeve studentore të fakultetit.

Në tabelën në mënyrë më të detajuar janë treguar të dhënat lidhur me procesin e zgjedhjeve studentore në fakultetet dhe shkollën e lartë profesionale në korniza të USHKO. E konsiderojmë datën e publikimit të shpalljes si një datë e vlefshme nga e cila fillon të rrjedhë perioda 30-ditore për mbajtjen e zgjedhjeve.

Emri i njësisë	Data e shpalljes së zgjedhjeve studentore	Afati për paraqitjen e kandidatëve	Data e mbajtjes së zgjedhjeve studentore	A zgjedhjet janë mbajtur brenda 30 ditëve?
Fakulteti juridik – Kërçovë	05.09.2019	7 ditë	27.09.2019	PO
Fakulteti ekonomik – Prilep	30.04.2019 ⁴	7 ditë	20.05.2019	PO
Fakulteti i shkencave bioteknike – Manastir	22.04.2019	7 ditë	17.05.2019	PO
Fakulteti i shkencave teknike – Manastir	02.05.2019	7 ditë	27.05.2019	PO
Fakulteti i pedagogjisë – Manastir	25.04.2019	7 ditë	27.05.2019	JO
Fakulteti i turizmit dhe hotelerisë - Ohër	06.11.2019	7 ditë	06.12.2019	PO
Fakulteti i sigurisë – Shkup	03.09.2019 / 17.09.2019 ⁵	7 ditë	16.10.2019	PO
Fakulteti i shkencave teknologjike dhe teknike – Veles	17.05.2019 ⁶	7 ditë	31.05.2019	PO
Fakulteti i mjekësisë veterinarë - Manastir	06.11.2019	7 ditë	18.11.2019	PO

⁴ Shpallja për aplikim të kandidatëve është e shpallur më 20.04.2019, por mbi vendim të miratuar më parë me nr. 02-373/1 më 19.04.2019

⁵ Në thirrjen e parë aplikon vetëm një (1) kandidat, dhe për shkak të numrit të pamjaftueshëm të kandidatëve të paraqitur për anëtarë të KSF, thirrja publike është shpallur përsëri.

⁶ Shpallja për aplikim të kandidatëve është e shpallur më 17.05.2019, por mbi vendim të miratuar më parë me nr. 02-219/2 më 30.04.2019


Fakulteti i shkencave të informatikës dhe teknologjive të komunikimit – Manastir	25.04.2019	7 ditë	27.05.2019	JO
Shkolla e lartë mjekësore – Manastir	02.05.2019 ⁷	7 ditë	30.05.2019	PO

Procesi i votimit: Në fakultetet, që ishin objekt i monitorimit të drejtpërdrejtë në ditën zgjedhore, komisionet zgjedhore kanë pasur një listë zgjedhore. Në çdo lokacion ku ishte organizuar votimi kishte siguruar një kuti votimi dhe paravanë për të siguruar fshehtësinë e votimit. Në Fakultetin e turizmit dhe hotelerisë – Ohër ishte vërejtur video vëzhgim në hapësirën ku votohej, që pengonte fshehtësinë e votimit. Fletëvotimet ishin vulosur me vulën e fakultetit. E drejta e votimit realizohet me indeksin e studentëve, dhe vetëm në një numër të vogël të rasteve është vërejtur devijim në lidhje me kërkimin e indeksit para dhënies së fletëvotimi. Procedura e votimit ishte shpjeguar secilit student. Pas përfundimit të zgjedhjeve ishin numëruar votat dhe ishin regjistruar në një procesverbal përkatës.

⁷ Shpallja për aplikim të kandidatëve është e shpallur më 02.05.2019, por mbi vendim të miratuar më parë me nr. 02-225/1 më 30.04.2019


Përfaqësuesit e studentëve në kuvendet studentore të fakultetit

Proporcioni i anëtarëve të paraqitur dhe të zgjidhur në kuvendet studentore e fakultetit
Zgjedhjet studentore në Universitetin “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir




■ Gjithsej votat


■ Të papërdorura




Fakulteti i shkencave teknike –
Manastir




Fakulteti i shkencave bioteknike –
Manastir




Fakulteti ekonomik – Prilep




Fakulteti i pedagogjisë – Manastir




Fakulteti i turizmit dhe hotelërisë - Ohër




Fakulteti i sigurisë – Shkup




Fakulteti juridik – Kërçovë



Fakulteti i shkencave teknologjike dhe teknike - Manastir



Shkolla e lartë mjekësore – Manastir



Fakulteti i mjekësisë veterinare - Manastir

Gjetjet kryesore

- Universiteti “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir nuk praktikon një qasje të koordinuar në zgjedhjet studentore dhe konstituim i kuvendeve studentore të fakulteteve. Çdo fakultet dhe/ose shkolla e lartë profesionale, që funksionojnë në korniza të Universitetit, kanë autonominë për të miratuar në mënyrë të pavarur modelin e organizimit studentor dhe zgjedhjeve studentore në përputhje me ligjin.

- Numri i anëtarëve të kuvendeve studentore të fakultetit nuk është i njëjtë për të gjitha fakultete. UShKO nuk rregullon numrin e anëtarëve të kuvendeve studentore të fakultetit, as procedurën e përzgjidhjes së anëtarëve dhe kryetarit të kuvendeve studentore të fakultetit.

- Përfaqësuesit e kuvendeve studentore të fakultetit përzgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, fer dhe demokratike me votim të fshehtë.

- Kryetarët e kuvendeve studentore të fakultetit përzgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, fer dhe demokratike në korniza të zgjedhjeve të njëjta në të cilat zgjidhen edhe anëtarët e kuvendeve studentore të fakultetit.

- Zgjedhjet studentore nuk shpallen në të njëjtën kohë. Dekani, d.m.th., drejtori i secilit fakultet, d.m.th., i secilës shkollë të lartë profesionale në mënyrë të pavarur vendos kur do të shpallen dhe mbahen zgjedhjet.

- Në vendimet për shpallje të zgjedhjeve studentore emërohen komisionet zgjedhore. Të gjitha komisione zgjedhore janë përbërë nga pesë (5) anëtarë, nga të cilët tre (3) studentë dhe dy (2) profesorë ose bashkëpunëtorë. Komisionet zgjedhore kanë kompetencë për të formuar këshillat zgjedhore ose nënkomisionet për zbatimin e procesit zgjedhor, dhe ato janë përbërë nga dy (2) studentë dhe një (1) profesor ose bashkëpunëtor.

- Afati për aplikim të kandidatëve për përfaqësues të studentëve në kuvendet studentore të fakultetit në të gjitha fakultete të UShKO është i njëjtë dhe zgjat shtatë (7) ditë.

- UShKO përdor tre media dhe kanale kryesore për të informuar studentët lidhur me procesin zgjedhor, si vijon: faqet e internetit, rrjetet sociale dhe dërrasat e shpalljeve të fakulteteve.

- Nuk ka një datë të unifikuar për mbajtjen e zgjedhjeve studentore në UShKO. Zgjedhjet studentore në fakultetet dhe shkollën e lartë profesionale u mbajtën në ditë të ndryshme, madje edhe në muaj të ndryshëm, në varësi të vendimit të secilit fakultet individualisht.

- Në disa fakultete në korniza të UShKO ekziston një dallim kohor midis ditës së miratimit të vendimit të dekanit lidhur me shpalljen e zgjedhjeve studentore dhe ditës së shpalljes faktike të thirrjes publike për kandidatë për anëtarë dhe kryetar të kuvendit studentor të fakultetit.

- Në dy (2) fakultete (Fakulteti i pedagogjisë – Manastir dhe Fakulteti i shkencave të informatikës dhe teknologjive të komunikimit – Manastir), zgjedhjet studentore u mbajtën më vonë se periudha e përcaktuar me ligj prej

30 ditëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve studentore.

- Në një (1) fakultet (Fakulteti i sigurisë – Shkup) dy (2) herë është shpallur thirrja për kandidatë për anëtarë dhe kryetar të kuvendit studentor të fakultetit, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të kandidatëve të paraqitur në thirrjen e parë.

- UShKO nuk ka vendosur një model zgjedhor në rast kur më shumë kandidatë do të marrin numrin e njëjtë të votave, dhe numri i vendeve në kuvendin studentor të fakultetit është i kufizuar.

- Dalja e përgjithshme në zgjedhjet studentore në nivel të Universitetit është 19.3%. Në përgjithësi, dalje më e madhe ka në fakultetet ku ka regjistruar një numër më i ulët i studentëve. Në përqindje, dalja më e madhe është në

- Shkollën e lartë mjekësore, Fakultetin e mjekësisë veterinare – Manastir dhe Fakultetin e pedagogjisë – Manastir, dhe dalja më e ulët është në Fakultetin juridik – Kërçov dhe Fakultetin e sigurisë – Shkup.

- Kuvendi studentor i Universitetit të UShKO përbëhet nga gjithsej 22 anëtarë – nga dy (2) delegatë nga secili kuvendi studentor i fakultetit.

- Kryetari i kuvendit studentor të Universitetit zgjidhet nga radha e anëtarëve të vetë kuvendi me votimin e delegatëve dhe i njëjti ka statusin e një student të rregullt.

- UShKO rregullon strukturën e brendshme dhe procedurën për zgjidhje të organeve të brendshme të kuvendit studentor të Universitetit me Statutin e Universitetit.

- Kuvendi studentor i Universitetit të UShKO ka kryetar, organ ekzekutiv, i përbërë nga pesë (5) anëtarë dhe organ mbikëqyrës, i përbërë nga tre (3) anëtarë.

Rekomandimet

- Me Statutin të rregullohet korniza, e cila do të garantojë një numër minimal dhe maksimal të anëtarëve në kuvendet studentore të fakultetit dhe një procedurë për zgjedhjet studentore. Kuvendet studentore e fakultetit janë organet e fakulteteve, ashtu si këshillat mësimore-shkencore ose Senati i Universitetit, për shkak se rregullimi i tyre bëhen një çështje statutoare. Është pasigurt si konstituohen kuvendet e para studentore të fakultetit pa procedurë të miratuar për zgjedhje dhe kornizë për numrin e anëtarëve të kuvendeve, që sipas Statutit të UShKO, duhet të rregullohet në mënyrë të pavarur nga ana e kuvendeve studentore të fakultetit.

- UShKO hyn në autonominë e kuvendit studentor të Universitetit, duke rregulluar strukturën e brendshme dhe procedurën e zgjidhjes së organeve të kuvendit studentor të Universitetit. KSU zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e kuvendeve studentore të fakultetit, për shkak se kuvendi në statutin e tij dhe aktet e brendshme mund dhe duhet ta rregullojë në mënyrë të pavarur mënyrën e zgjidhjes dhe strukturën e brendshme.

- Të vazhdojë praktika e përdorimit të të gjitha mediave të Universitetit për të informuar studentët në mënyrë transparente lidhur me procesin e zgjedhjeve studentore në përgjithësi, me atë që faqet e internetit të fakulteteve do të përditësohen në kohën e duhur.

- Të vendoset praktika e mbajtjes së zgjedhjeve studentore në të njëjtën ditë ose të paktën në të njëjtin muaj dhe atë në fillim të vitit akademik. Kjo do të mundësojë një angazhim më të madh të studentëve dhe një gamë më të gjerë të informacioneve deri te studentët.

- Të praktikohet një afat më të madh kohor për informim dhe për aplikim të studentëve për anëtarë të kuvendeve studentore të fakultetit. Afati nga shtatë (7) ditë duket se është i pamjaftueshëm për një informim të plotë të studentëve dhe për dorëzim të dokumentacionit të nevojshëm.

Avokati studentor

Struktura e organizimit: Çdo universitet duhet të ketë avokatin studentor, që vepron në nivel të Universitetit dhe kujdeset për të mbrojtur të drejtat e studentëve kur janë shkellur nga ana e organeve të Universitetit ose anëtarëve të komunitetit akademik të Universitetit dhe zëvendësavokatit studentor të secilës njësie (fakultet ose shkollë e lartë profesionale) në korniza të atij Universiteti, që kujdesen për mbrojtjen e të drejtave të studentëve, që janë shkellur nga ana e organeve të një njësie konkrete ose anëtarëve të komunitetit akademik të asaj njësie.

Avokati studentor

Çdo universitet duhet ta ketë avokatin studentor, si një organ që do të mbrojë të drejtat e studentëve në korniza të Universitetit.

Kriteret e përzgjidhjes: Ombudsmani studentor duhet të jetë studentë i rregullt.

Procedura e përzgjidhjes: Kuvendi studentor i Universitetit e propozon avokatin studentor pas një konkurs të shpallur më parë, dhe e zgjidh Senatin e Universitetin me shumicë të votave.

Mandat: Avokati studentor ka mandat nga 2 (dy) vite, pa të drejtën e rizgjidhjes. Kjo do të thotë që një student vetëm një herë mund të jetë avokat studentor dhe kjo për një periudhe prej vetëm dy vitesh.

Procedura e shkarkimit: Procedura për shkarkimin e avokatit studentor mund të inicohet nga kuvendi studentor i Universitetit, dhe vendimi përfundimtar për shkarkim e miraton Senatin e Universitetit, me shumicë të votave, ashtu si edhe për përzgjidhjen e tij.

Mënyra e veprimit: Avokati studentor vepron me kërkesë të një studenti ose me iniciativë të tij. Me iniciativë të tij, avokati studentor mund të veprojë nëse i veti ka konstatuar se është e shkellur e drejta e ndonjë studenti nga ana e organeve të Universitetit ose nga ana e ndonjë anëtar të komunitetit akademik të Universitetit.

Organet e institucionit të arsimit të lartë janë të detyruara për të vepruar në përputhje me udhëzimet e avokatit studentor.

Raportimi: Avokati studentor është i detyruar për të paraqitur një raport vjetor për punën e tij deri te Senati i Universitetit.

Kriteret shtesë për përzgjidhjen e avokatit studentor, procedurën e përzgjidhjes dhe shkarkimit të tij dhe punën e avokatit studentor mund të përcaktohen me akte të Universitetit dhe Kuvendit studentor të Universitetit.

Zëvendës i avokatit studentor

Çdo fakultet duhet të ketë zëvendës i avokatit studentor, që do të mbrojë të drejtat e studentëve në atë fakultet.

Kriteret e përzgjidhjes: Zëvendësi i avokatit studentor duhet të jetë student i rregullt.

Procedura e përzgjidhjes: Zëvendësi i avokatit studentor zgjidhet përmes një thirrje publike nga Kuvendi studentor i fakultetit.

Procedura e shkarkimit: Procedura për shkarkimin e zëvendësit të avokatit studentor mund ta inicojnë:

- Anëtarët e Kuvendit studentor të fakultetit,
- Avokatin studentor, ose
- 1/10 e numrit të përgjithshëm të studentëve, që janë regjistruar në atë moment në fakultetin ku është zgjidhur zëvendësin e avokatit studentor. Vendimi për shkarkim miratohet nga Kuvendi studentor i fakultetit.

Mandati: Zëvendësi i avokatit studentor, ashtu si avokati studentor, kanë një mandat prej dy (2) vitesh, pa mundësi për rizgjidhje. Kjo do të thotë se një student mund të zgjidhet vetëm dy vite si zëvendës i avokatit studentor në atë fakultet.

Mënyra e veprimit: Zëvendësi i avokatit studentor, ashtu si avokati studentor, vepron me kërkesë të një studenti ose me iniciativë të tij. Zëvendësi i avokatit studentor vepron në mënyrë të pavarur nëse ai i veti ka konstatuar se është e shkullur e drejta e ndonjë studenti nga ana e organeve të fakultetit ose nga ana e ndonjë anëtar tjetër të komunitetit akademik në atë fakultet. Organet e fakulteteve janë të detyruara për të vepruar në përputhje me udhëzimet e zëvendësit të avokatit studentor.

Raportimi: Zëvendësit e avokatëve studentor janë të detyruar për të paraqitur raporte vjetore deri te Kuvendet studentore e fakultetit dhe këshillat mësimdhënës-shkencore e njësisë në të cilën janë zgjidhur.

Kriteret shtesë për përzgjidhjen e zëvendësve të avokatëve studentor, procedurën e përzgjidhjes dhe shkarkimit dhe punën e tyre mund të përcaktohen me akte të fakulteteve dhe kuvendeve studentore të fakultetit.

Statutet e Universitetit “Goce Delçev” – Shtip dhe Universitetit “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir nuk i rregullojnë në mënyrë më të detajuar punën, kriteret dhe mënyrën e përzgjidhjes dhe shkarkimit të avokatëve studentor dhe zëvendësve të tyre. Kuvendet studentore në mënyrë autonome e rregullojnë këtë mundësi.

Universiteti “Goce Delçev” - Shtip

Në Universitetin “Goce Delçev” – Shtip ende nuk është zgjidhur as avokati studentor, as zëvendësi i avokatit studentor në korniza të njësisë të Universitetit.

Shpallja e konkurseve publike dhe procedurat e përzgjidhjes së avokatit studentor dhe zëvendësve të avokatëve studentor janë vonuar me kohë të pacaktuar, deri në përfundimin e gjendjes së jashtëzakonshme, e shpallur për shkak të parandalimit të paraqitjes, përhapjes dhe menaxhimit të koronavirusit COVID-19.⁸

⁸ Vendimi për përcaktimin e ekzistimit të gjendjes së jashtëzakonshme nr. 08-526/2 më 18.03.2020 (Gazeta zyrtare e RMV-së më 18.03.2020)

Univeristeti “Sh. Kliment i Ohrit” - Manastir

Universiteti “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir ka zgjidhur avokatin studentor e UShKO dhe zëvendësitë e avokatëve studentor në të gjitha fakultete dhe shkollën e lartë mjekësore të UShKO, me mandat nga dy (2) vite.

Avokati studentor

Koha dhe mënyra e shpalljes së konkursit për avokat studentor: Kuvendi studentor i Universitetit të UShKO më 21.01.2020 ka shpallur një thirrje për zgjidhjen e avokatit studentor.

Afati për aplikim: Afati për aplikim të kandidatëve për avokat studentor të UShKO ishte 15 ditë, d.m.th., deri më 04.02.2020. Komision i konkursit: Kuvendi studentor i Universitetit ka formuar një komision konkursi pranë KSU UShKO, që është i detyruar për pranimin dhe shqyrtimin e kandidaturave për avokat studentor.

Dukshmëria dhe transparenca e thirrjes për zgjidhjen e avokatit studentor: Universiteti “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir dhe Kuvendi studentor i Universitetit kanë përdorur tre (3) lloje të mediave për të informuar studentët lidhur me mundësinë e kandidimit për avokat studentor, si vijon:

- Faqa e internetit të UShKO dhe faqet e internetit të secilit fakultet të UShKO
- Dërrat e shpalljeve në selinë dhe kampuset e të gjitha fakulteteve
- Radioja studentore e Universitetit UShKO FM

Kriteret e përzgjidhjes: Për avokat studentor të UShKO, kandidatët duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative dy kriteret e mëposhtme:

- Të jenë studentë të rregullt në ndonjë prej fakulteteve ose shkollën e lartë mjekësore të UShKO, dhe
- Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)

Data dhe mënyra e përzgjidhjes: Kuvendi studentor i Universitetit të UShKO me propozim të Komisionit të konkursit, brenda tetë (8) ditëve pas përfundimit të konkursit, përcakton një propozim për Avokat studentor, që dorëzon deri te

Senati i UShKO. Senati i Universitetit zgjidh avokatin studentor jo më vonë se 15 ditë pas dorëzimit të propozimit nga ana e Kuvendit studentor të Universitetit.

Në konkurstin për Avokat studentor kanë aplikuar gjithsej dy (2) kandidatë. Senati i UShKO në sesionin e tij të 178-të, i mbajtur më 26.02.2020 ka miratuar një Vendim për zgjidhjen e avokatit studentor.

Në tabelën në mënyrë më të detajuar janë treguar të dhënat lidhur me procesin e përzgjidhjes së avokatit studentor në Universitetin “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir.

Universiteti	Data e shpalljes së konkursit	Afati i aplikimit	Kritetet	Dokumentet për aplikim	Data e përzgjidhjes	Numri i kandidatëve të paraqitur
Universiteti “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir	21.01.2020	15 ditë Deri më 04.02.2020	1) Të jenë studentë të rregullt në ndonjë prej fakulteteve ose shkollën e lartë mjekësore në korniza të UShKO 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë CV (në formatin Europass) 5) Letër motivimi	26.02.2020	2

Zëvendësitë e avokatëve studentor

Në të gjitha fakultetet dhe në shkollën e lartë mjekësore në kuadra të Universitetit “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir u zgjedhën zëvendësitë e avokatëve studentor, me një mandat prej dy (2) vitesh.

Koha dhe mënyra e shpalljes së konkursit për avokat studentor: Kuvendet studentore të fakultetit kanë shpallur një konkurs për zgjidhjen e zëvendësit të avokatit studentor me një vendim të posaçëm, në çdo fakultet individualisht.

Afati i aplikimit: Afati për aplikim të kandidatëve për zëvendësitë e avokatëve studentor në të gjitha fakultete dhe shkollën e lartë mjekësore të UShKO ka qenë i barabartë, d.m.th., kohëzgjatje e konkursit prej 15 ditëve.

Dukshmëria dhe transparenca e thirrjes për zgjidhjen e avokatit studentor: Kuvendet studentore e fakultetit dhe fakultetet në të cilat ata operojnë kanë përdorur tre (3) lloje të mediave për të informuar studentët lidhur me mundësinë e kandidimit për zëvendës të avokatëve studentor, si vijon:

- Faqja e internetit të UShKO dhe faqet e internetit të secilit fakultet në korniza të UShKO
- Dërrasat e shpalljeve në selinë dhe kampuset e të gjitha fakulteteve
- Radioja studentore e Universitetit UShKO FM

Kriteret e përzgjidhjes: Për zëvendës të avokatit studentor në çdo fakultet dhe në shkollën e lartë mjekësore të UShKO, kuvendet studentore e fakultetit kanë pasur kritere të unifikuara. Kandidatët duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative dy kriteret e mëposhtme:

- Të jenë studentë të rregullt në fakultetin ku zgjidhen si zëvendës i avokatit studentor, dhe
- Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)

Në tabelën në mënyrë të detajuar janë treguar të dhënat lidhur me procesin e përzgjidhjes së zëvendësit të avokatëve studentor në çdo fakultet dhe në shkollën e lartë mjekësore në kuadrat e Universitetit “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir.

Fakulteti	Data e shpalljes së konkursit	Afati i aplikimit	Kriteret	Dokumente të nevojshme për aplikim
Fakulteti juridik - Kërçovë	24.02.2020	15 ditë Deri më 09.03.2020	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë 5) Letër motivimi

Fakulteti i shencave teknologjike-teknike – Veles	30.01.2020	15 ditë Deri më 13.02.2020	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë 5) Letër motivimi
Shkolla e lartë mjekësore – Manastir	24.12.2019	15 ditë Deri më 08.01.2020	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë
Fakulteti i shkencave të informatikës dhe teknologjive të komunikimit – Manastir	22.01.2020	15 ditë Deri më 05.02.2020	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë 5) Letër motivimi
Fakulteti ekonomik – Prilep	11.12.2019	15 ditë Deri më 26.12.2019	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë

Fakulteti i mjekësisë veterinare – Manastir	03.12.2019	15 ditë Deri më 19.12.2019	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë 5) Letër motivimi
Fakulteti i shkencave bioteknike - Manastir	26.11.2019	15 ditë Deri më 11.12.2019	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë 5) Letër motivimi
Fakulteti i sigurisë - Shkup	25.11.2019	15 ditë Deri më 09.12.2019	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë 5) Letër motivimi
Fakulteti i shkencave teknike – Manastir	19.11.2019	15 ditë Deri më 04.12.2019	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë

Fakulteti i turizmit dhe hotelerisë - Ohër	21.01.2020	15 ditë Deri më 04.02.2020	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë 5) Letër motivimi
Fakulteti i pedagogjisë - Manastir	/	/	1) Studentë të rregullt 2) Të kenë të paktë notë mesatare e studimeve mbi tetë (8)	1) Aplikacion 2) Vërtetim për student të rregullt 3) Vërtetim për notë mesatare nga studimet 4) Biografia e shkurtë 5) Letër motivimi

Zëvendësitë e avokatëve studentor janë zgjidhur në nëntë (9) prej gjithsej 11 njësite të Universitetit “Sh. Kliment i Ohrit” – Manastir. Në Fakultetin ekonomik – Prilep dhe në Fakultetin e pedagogjisë – Manastir ende nuk janë zgjidhur zëvendësitë e avokatëve studnetor për shkak të mungesës së studentëve të interesuar për këtë pozicion.

Rekomandime të përgjithshme

• **Çdo universitet të përcaktojë një kornizë e saktë kohore dhe kalendar zgjedor në lidhje me zgjedhjet studentore** ku do të dihet paraprakisht në të cilën periudhë të vitit akademik do të shpallen konkurset për zgjidhjen e përfaqësuesve të studentëve në kuvendet studentore dhe për avokatin studentor dhe zëvendësitë e tij, cili është afati i aplikimit etj.

• Zgjedhjet studentore shpallen në kohë **në fillim të secilit vit akademik.**

• Kuvendet e Universitetit dhe kuvendet studentore në aktet e tyre të brendshme të sigurojnë **mundësi të barabarta për pjesëmarrje të studentëve me aftësi të kufizuara në zgjedhjet.** Universitetet të mundësojnë edhe kushte teknike dhe qasje deri te lokacionet ku mbahen zgjedhjet studentore për këto kategori të studentëve.

• Kuvendet e universiteteve dhe kuvendet studentore të sigurojnë **zbatimin e procedurave në kohë për zgjidhjen e avokatëve studentor dhe zëvendësve të tij.** Mundësia për mbrojtjen efiçase e të drejtave të studentëve përmes avokatëve studentor dhe zëvendësve të tij duhet të jenë në dispozicion të studentëve gjatë gjithë vitit akademik

• Universitetet të praktikojnë **afate më të mëdha për informimin dhe aplikimin** e studentëve për anëtarë të kuvendeve studentore të fakultetit.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент
Охридски”, Скопје

324-057.875:378.4(497.7)(047.31)

АНГЕЛОВА, Мариана

Нов бран во студентското организирање : анализата на студентското (ре)формирање на државните универзитети во Штип, Битола и Тетово е / [автори Мариана Ангелова, Кристијан Панев]. - Скопје : Национален младински совет на Македонија, 2020. - 42 стр. : илустр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Публикацијата е во рамки на проектот:
“Студентско (ре)формирање”

ISBN 978-608-65879-5-6

1. Панев, Кристијан [автор]

а) Студенти - Избори - Македонија - Истражувања

COBISS.MK-ID 51398405

